



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 4923/1 Prot.

Tiranë, më 14/5 /2019

**URDHËR**

Nr. 175, Datë 14.5 2019

**“PËR SHPALLJEN E DISA NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 3 “INSTRUMENTET FINANCIARE”, STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 5 “AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE”, STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 11 “TATIMI MBI FITIMIN” DHE STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 13 “AKTIVET BIOLOGJIKE DHE MARRËVESHJET KONCESIONARE” TË PËRMIRËSUARA”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 5, të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të nenit 11, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e disa ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 3 “Instrumentet Financiare” (SKK 3), Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale” (SKK 5), Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 11 “Tatimi mbi fitimin” (SKK 11) dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 13 “Aktivet Biologjike dhe Marrëveshjet Koncesionare”, të përmirësuara.
2. Ndryshimet e SKK 3, SKK 5, SKK 11 dhe SKK 13, të përmirësuara, të publikuara në vitin 2019, kanë datë efektive 1 Janar 2020 dhe do të zbatohen në perspektivë, pa kërkuar riparaqitjen e pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

